

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: BLERJE PRAJMER(emulsion bitumi)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP)

44113100-6

VLERA E FONDIT LIMIT I KONTRATËS: 4 166 662.5(katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy presje pesë lekë).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Ndermarrja e Sherbimeve Publike Vlore, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Nw zbatim tw nenit 83 te Ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020) është 2% e fondit limit.

Argumentimi: *Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me Nenin 82 “Formulari permbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe ne mbeshtetje te nenit 26, nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik te ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklarimit me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve e fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: " Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata".*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetare, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme."

Sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës Procedurë e hapur të thjeshtuar, edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2 (c) e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.2.3 Vërtetimi të shlyerjes së taksave e tarifave vendore për vitin 2025 në të gjithë adresat e ushtrimit të aktivitetit sipas ekstraktit të QKB-së.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024; në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për kontrata të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe

të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar duke qënë se vlera e fondit limit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.*

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i autorizuar për mallrat e ofertuara ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar. Në rast se të paraqitjes së autorizimit nga distributori i autorizuar duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: *Autorizimi i prodhuesit është dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kriteri është hartuar në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Autoriteti kontraktor, duke qënë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Në këtë kontekst, është garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.*

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

- Duhet të përmbajë bitum të modifikuar SBS; përmban bitum të modifikuar SBS;
- me ngjitje të lartë në bazë dhe hidroizolim të aplikuar;
- me elasticitet të lartë;
- rezistent ndaj kushteve të vështira atmosferike;
- nuk përmban tretës organikë;
- mund të aplikohet në sipërfaqe të lagura;
- nuk merr flake;
- tharje e shpejtë (15-30 minuta);
- i lehtë për t'u përdorur;
- Të ketë ngjitje të lartë në bazë
- Të ketë elasticitet të lartë;
- Të jetë rezistent ndaj kushteve të vështira atmosferike;
- Nuk duhet të përmbajë tretës organikë;
- Nuk duhet të jetë i aplikoheshëm në sipërfaqe të lagura;
- nuk duhet të marrë flake;
- tharje e shpejtë (15-30 minuta);
- I lehtë për t'u përdorur;
- **Malli objekt prokurimi duhet të levrohet me konteniere 500-1000 L.**

Argumentimi: *Specifikimet teknike janë hartuar nga autoriteti kontraktor për artikujt objekt prokurimi referuar nevojës reale, duke përcaktuar informacionin minimal të nevojshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke u referuar për disa artikuj. Specifikimet teknike të përcaktuara në këto dokumente tenderi i përgjigjen nevojës së autoritetit kontraktor, çka nënkupton plotësimin e nevojave me cilësinë e kërkuar.*

Përdorimi i bitumit të modifikuar me SBS garanton rritje të elasticitetit dhe fleksibilitetit të materialit, rezistencë më të lartë ndaj plasaritjeve dhe deformimeve, performancë më të mirë në temperatura ekstreme.

Ky lloj modifikimi është standard në aplikimet rrugore për të përballuar ngarkesat dinamike dhe kushtet klimatike.

Materiali duhet të sigurojë aderencë të fortë me sipërfaqen ekzistuese (asfalt/beton) dhe krijimin e një shtrese hidroizoluese efektive.

Ngjitja e lartë parandalon shpëputjen e shtresës, ndërsa hidroizolimi mbron strukturën rrugore nga depërtimi i ujit, i cili është një nga faktorët kryesorë të degradimit.

Elasticiteti i materialit mundëson përthithjen e lëvizjeve të sipërfaqes rrugore, shmangien e çarjeve dhe dëmtimeve të parakohshme.

Rrugët janë subjekt i deformimeve nga trafiku dhe ndryshimet termike; elasticiteti është kritik për jetëgjatësinë.

Materiali duhet të jetë rezistent ndaj rrezeve UV, temperaturave të larta dhe të ulëta, lagështirës dhe reshjeve.

Kushtet atmosferike në terren kërkojnë materiale që nuk degradohen lehtësisht dhe ruajnë vetitë në kohë.

Mungesa e tretësve organikë siguron përdorim më të sigurt për operatorët dhe ndikim më të ulët në mjedis.

Përputhet me kërkesat moderne për mbrojtjen e mjedisit dhe standardet e sigurisë në punë.

Materiali duhet të jetë i aplikueshëm edhe në kushte lagështie.

Kjo rrit fleksibilitetin operacional dhe shmang vonesat në punime, sidomos në kushte jo ideale atmosferike.

Mosndezshmëria (nuk merr flakë) siguron nivel të lartë sigurie gjatë transportit dhe aplikimit.

Redukton rrezikun e aksidenteve dhe është kërkesë thelbësore për materiale ndërtimi.

Tharje e shpejtë (15–30 minuta) lejon rikthim të shpejtë të trafikut dhe reduktim të ndërprerjeve në qarkullim.

Element kyç për ndërhyrje në zona urbane dhe rrugë me trafik të lartë.

Materiali duhet të jetë praktik për aplikim (manual ose mekanik) pasi rrit efikasitetin e punës dhe ul kostot operative.

Paketimi në kontenierë 500–1000 L lehtëson transportin dhe magazinimin dhe është e përshtatshme për përdorim në terren.

Siguron menaxhim më të mirë logjistik dhe shmang humbjet e materialit.

Specifikimet teknike të përcaktuara janë të nevojshme për të garantuar cilësi dhe qëndrueshmëri të lartë të materialit, siguri gjatë aplikimit dhe përdorimit, efikasitet në realizimin e punimeve, përputhshmëri me standardet bashkëkohore të infrastrukturës rrugore.

Këto kërkesa nuk janë kufizuese, por të domosdoshme për të siguruar performancë optimale.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizon personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT: